



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2520/ 3 prot.,

Datë 06.112023

V E N D I M
Nr. 1126/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.11.2023 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor në lidhje me anulimin e vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-77870-08-18-2023, me objekt “*Shërbim Lavanderie për Spitalin Rajonal, Fier*”, me fond limit 51,224,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20-09-2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Devis” SHPK me NIPT K31420012M
Adresa: Njësia Bashkiake Nr. , Rruga: “Siri Kodra”, Magazina 10 kati 1, në Zonën Kadasrale 8330, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Adresa: Blv ”Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e larte monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21-08-2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-77870-08-18-2023, me objekt “Shërbim Lavanderie për Spitalin Rajonal, Fier”, me fond limit 51,224,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20-09-2023, nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datë 14-09-2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 09.10.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (SPE), se ka anuluar procedurën e prokurimit.

II.4. Në Buletinin Nr. 86 datë 16. 10.2023 të Agjencisë së Prokurimit Publik është publikuar formulari i njoftimit të anulimit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë:

“[...]Arsyet e Anulimit: në zbatim të pikës

c), të nenit 98 të Ligjit Nr.162/2020 ku përcaktohet se

“konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;”

II.5. Në datën 26.10.2023, nr. prot 1333/5, autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën protokolluar me tonën, datë 27.10.2023, nr. prot 2520/2, me objekt “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim lavanderie, për Spitalin Rajonal Fier”.

II.6 Nga verifikimet e kryera, rezulton, se janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara, lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Devis” SHPK, mbi kundërshtimin e anulimit të procedurës së prokurimit me arsyen se:

“[...]Ne këtë akt mungon pjesa arsyetuese mbi të cilën është nxjerrë akti, shpjegimet e rezultatit të vendimit administrativ dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij zbatohen në rastin konkret, çka provon se ky akt/vendim është i paarsyetuar (një ndërparimet bazë të aktit Administrativ) dhe duhet të deklarohet i pavlefshëm pasi cenon interesat e ligjshme të operatorëve ekonomik pjesëmarrës dhe vjen në kundërshtim me dispozitat e ligjit si të LPP-së dhe të K.Pr.Adm.

Pra ligji ka vendosur se duhet të plotësohet të dy kushtet kumulative që të anulohet procedura e prokurimit. A) vlerësimi i KVO-së b) Argumentimi se kush kriter bie ndesh me ligjin material ose ligjin e fushës përkatëse. Ne cdo akt administrativ elementet thelbësore, që nënkuptojnë si përmbajtjen edhe formën e tij, janë autoritetësia e aktit, përshkrimi i lëndës dhe i subjekteve që u drejtohet, arsyetimi dhe dispozitivi. Përmbajtja e aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe i përcaktuar mirë. Këto elemente të formës dhe përmbajtjes së një akti administrativ janë tepër të rëndësishme dhe nuk mund të injorohen. Ato konsiderohen pjesë përbërëse e vet aktit dhe mosrespektimi ose moszbatimi i tyre mund të ndikoj drejtpërdrejt në rregullsinë dhe në vlefshmërinë e tij. Arsyetimi i aktit/vendimit duhet të përfaqësojë faktet thelbësore, boshthin logjik dhe bazat ligjore që ka pasur parasysh autoriteti

kontraktor. Nëpërmjet arsytimit të aktit qartësohet qëllimi që ka patur organi administrativ në vendimmarrje. Arsyetimi përbën një element thelbësor të formës dhe përmbajtjes së aktit/veprimit administrativ dhe ndikon drejtpërdrejt në vlefshmërinë e tij. Sipas nenit 108, të Kodit të Procedurave Administrative, mosrespektimi i formës dhe elementëve së caktuar nga ligji është shkak për pavlefshmërinë absolute të aktit.. Kështu, duhet të arsyetohen të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë ose prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejtat dhe interesat e ligjshëm të subjekteve të cilëve u drejtohen. NË rastin konkret mungojnë elementë të formës dhe përmbajtjes së aktit administrativ e për rrjedhojë akti administrativ është i pavlefshëm. SË dyti, çmujmë se të gjitha kriteret kualifikuese janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, kjo procedurë prokurimi është një procedurë e rishpallur nga ana e autoritetit kontraktor dhe në procedurën e mëparshme (REF-40205-08-30-2022.) Me po të njëjtat kriteret kualifikuese po ky autoritet kontraktor vendosi anulimin e procedurës së prokurimit me motivacionin se nuk kishte asnjë ofertë të vlefshme, Kjo procedurë e mëparshme prokurimi, ju nënshtrua dhe hetimit administrativ nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik i cili me vendimin Nr. 322/2023 Sa më sipër, nëpërmjet veprimi të tij, autoriteti kontraktor po cenon dhe parimin e sigurisë juridike. Parimi i sigurisë juridike presupozon, veç te tjerash besueshmërinë e qytetarit tek shteti dhe pandryshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të tjera të mëparshme (shih dhe vendimet e gjykatës Kushtetuese nr.37/2012, nr. 31 dt. 18.06.2010, nr. 24 datë 12.11.2009, nr. 9 datë 26.02.2007). Për sa më sipër shpjeguar, kërkohet: Anulimin e vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit..[...]", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.2. Autoriteti Kontraktor ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik në Komisionin e Prokurimit Publik, datë 26.10.2023 nr. prot 1333/5, autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve protokolluar me tonën datë 27.10.2023 nr. prot 2520/2 ku citon **“Arsyeja e ANULLIMIT”**.

Në mbështetje të nenit 75, pika 4, të VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", sipas të ciles: "Nese KVO vlereson dhe argumenton se një ose disa kriteret janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik dhe/ose legjislacionin e fushës në fuqi, ka të drejtë t'i propozojë Titullarit anulimin e procedurës.", në lidhje me procedurën e prokurimit "Procedure e Hapur mbi kufirin e lartë monetar", me objekt: "Sherbim Lavanderie, për Spitalin Rajonal, Fier", me fond limit: 51.224,000 (pesëdhjetë e një milion e dyqind e njëzet e katër mijë) Leke (pa TVSH), ose 487,708 (katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetë) Euro, pa TVSH, nr. REF-77870-08-18-2023, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, ju propozojmë anulimin e kësaj procedure për arsye se: Gjate procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të kësaj procedure prokurimi, KVO ka konstatuar paqartësi në lidhje me disa kriteret të percaktuara në DST, dhe konkretisht, në lidhje me pikat 6 dhe 7 të seksionit 2.3 "Kapaciteti Teknik" të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit. Pika 6, seksioni 2.3 "Kapaciteti Teknik" të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit percakton se: Operatori ekonomik në lidhje me materialin e bute të percaktuar në specifikimet teknike, që do të paraqesë, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet të leshuara nga

nje organ i autorizuar. Nr. Materialet e Buta Emertimi i produktit Spitali Rajonal, Fier Vendi i origjinës Certificate konformiteti ose cilësia CE/ekuivalent 1 2 3 Etj.

Gjate verifikimit te tabelave te paraqitura nga ofertuesit pjesemarrës ne kete procedure ne lidhje me kete kriter, kemi konstatuar se deklaratat per materialet e buta permbajne numer te ndryshem artikujsh dhe konkretisht: Deklarata e paraqitur nga OE "Devis" ShPK permban 24 artikuj, Deklarata e paraqitur nga OE "Mine Lloshi" PF permban 25 artikuj, Deklarata e paraqitur nga OE "Univers Servis" ShPK permban 20 artikuj dhe Deklarata e paraqitur nga OE "Wash & Go Laundry" ShPK permban 22 artikuj. Ne keto kushte, konsiderojme se mospercaktimi ne Tabele i zerave te produkteve nga ana e AK, ka sjelle konfuzion mes ofertuesve ne paraqitjen e tyre. Pika 7, seksioni 2.3 "Kapaciteti Teknik" te Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit percakton se: Operatori ekonomik ne lidhje me materialet e pastrimit qe do te perdoren per sherbimin e lavanderise e percaktuar ne specifikimet teknike, duhet te plotësoje tabelen e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjines si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i autorizuar. Nr. Materialet e pastrimit Emërtimi i produktit qe do te lahet Spitali Rajonal FIER Vendi i origjines se produktit te pastrimit Certificate konformiteti ose cilësia CE/ekuivalent 2 3 Etj. Edhe tek kjo tabele, konstatohet se kerkesa nuk perputhet me ate cka percaktohet ne tabele. Ne kerkese kerkohen te paraqiten "materialet e pastrimit qe do te perdoren", ndersa ne tabele "emertimi i produktit qe do te lahet". Kjo mosperputhje, ka shkaktuar konfuzion per ofertuesit, ku verehet se, 2 nga ofertuesit pjesemarrës kane paraqitur vetem materialet e pastrimit qe do te perdoren, ndersa 2 te tjere kane paraqitur si emertimin e produktit qe do te lahet ashtu edhe materialet e pastrimit qe do te perdoren. Mospercaktimet e produkteve dhe mosperputhjet e konstatuara ne kerkesat ne DST, me qellim permbushjen e kriterëve te percaktuara ne pikat 6 dhe 7 te seksionit 2.3 "Kapaciteti Teknik" te Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit, kane sjelle konfuzion edhe per KVO. Per sa me siper, KVO nuk mund te siguroje nje trajtim te barabarte ne vleresim per te gjithë OE pjesemarrës, prandaj, i propozojme Titullarit te AK, anulimin e kesaj procedure.

Kthim pergjigja e AK per operatorin ekonomik.

Komisioni i vleresimit te ofertave (KVO), nëpërmjet procesverbalit Nr. 1 Date 20.09.2023 "Për hapjen e ofertave te dorëzuara" ka hapur ofertat për procedurën e prokurimit "Sherbim lavanderie për Spitalin Rajonal, Fier". Në date 02.10.2023, KVO nëpërmjet procesverbalit nr. 2 "Per shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave", ka arsyetuar si vijon: "Gjate procesit te shqyrtimit dhe vleresimit te ofertave të kesaj procedure prokurimi, KVO konstaton paqartesi ne lidhje me pikat 6 dhe 7 te seksionit 2.3 "Kapaciteti Teknik" te Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit. Pika 6, seksioni 2.3 "Kapaciteti Teknik" te Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit percakton se: Operatori ekonomik ne lidhje me materialin e bute te percaktuar ne specifikimet teknike, qe do te paraqesë, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i autorizuar. Nr. Materialet e Buta Emertimi i produktit Vendi i origjinës Spitali Rajonal, Fier Certificate konformiteti ose cilësia CE/ekuivalent 1 2 3 Et. Paqartesia verehet gjate verifikimit te tabelave te paraqitura nga ofertuesit pjesemarrës ne kete procedure ne lidhje me kete kriter, ku konstatohet se deklaratat per materialet e buta permbajne numer te ndryshem artikujsh dhe konkretisht: Deklarata e paraqitur nga OE "Devis" ShPK permban 24 artikuj, Deklarata e paraqitur nga OE "Mine Lloshi" PF permban 25 artikuj, Deklarata e paraqitur nga OE "Univers Servis" ShPK permban 20 artikuj dhe Deklarata e paraqitur nga OE "Wash & Go Laundry" ShPK permban 22 artikuj. Pra, mospercaktimi ne Tabele i zerave te produkteve

nga ana e AK, ka sjelle konfuzion mes ofertuesve ne paraqitjen e tyre. Kjo situatë, sjell edhe pamundesine e KVO per te siguruar nje vleresim te barabarte.

Ndersa, Pika 7, seksioni 2.3 "Kapaciteti Teknik" te Kriterëve te Veçanta te Kualifikimit percakton se: Operatori ekonomik ne lidhje me materialet e pastrimit qe do te perdoren per sherbimin e lavanderise e percaktuar ne specifikimet teknike, duhet te plotesoje tabelen e meposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i autorizuar.

Nr. Materialet e pastrimit Spitali Rajonal Fier

Emertimi i produktit qe do te lahet; Vendi i Origjinës së Produktit; Certifikate konformiteti ose cilësia CE/ekuivalent

Nga sa me sipër, verehet se kërkesa nuk perputhet me atë cka percaktohet ne tabele. Ne kërkesë kerkohen te paraqiten "**materialet e pastrimit qe do te perdoren**", ndersa ne tabele "**emertimi i produktit qe do te lahet**". Edhe kjo mosperputhje, ka shkaktuar konfuzion per ofertuesit, ku verehet se, 2 nga ofertuesit pjesemarrës kane paraqitur vetem materialet e pastrimit qe do te perdoren, ndersa 2 te tjere kane paraqitur si emertimin e produktit qe do te lahet ashtu edhe materialet e pastrimit qe do te perdoren per produktet perkatese. Mospercaktimet e produkteve dhe mosperputhjet e konstatuara ne kërkesat ne DST, me qellim permbushjen e kriterëve te percaktuara ne pikat 6 dhe 7 te seksionit 2.3 "Kapaciteti Teknik" te Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit, sjellin konfuzion edhe per KVO. Prandaj, duke qene, se KVO nuk mund te siguroje nje trajtim te barabarte ne vleresim per te gjithë OE pjesemarrës, vendos qe t'i propozojë Titullarit te AK, anulimin e kesaj procedure."Ne pikën 7, te seksionit 2.3, te kriterëve te veçanta te kualifikimit, ne dokumentet e tenderit eshte përcaktuar:

5. Operatori ekonomik ne lidhje me materialet e pastrimit qe do te perdoren per sherbimin e lavanderise e percaktuar ne specifikimet teknike, duhet te plotesoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjines si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i autorizuar.

Nr. Materialet e pastrimit Spitali Rajonal Fier

Emertimi i produktit qe do të lahet Vendi i origjines Certifikate konformiteti ose cilësia CE/ekuivalent

Në çdo rast, perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraparak dhe nisjes se afateve te ankimit ofertuesi fitues duhet te paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti. Te dhenat qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates. Nga sa me sipër konstatohet se ne kërkesën e ketij kriteri eshte kerkuar qe operatori ekonomik duhet te plotesoje te dhenat e kerkuara ne tabele për materialet e pastrimit qe do te perdoren për sherbimin e lavanderise, nderkohe që ne tabelën e ketij kriteri keto te dhena kërkojnë produktet te cilat do te lahen. Kërkesa e ndryshme e produkteve Brenda te njëjtit kriter, ka sjelle si pasoje krijimin e konfuzionit si ne hartimin e dokumentacionit nga ana e ofertuesve, ashtu edhe gjate procesit te shqyrtimit e te vlerësimit te ofertave, si dhe duke krijuar hapësire per vleresim subjektiv te ofertave nga ana e anëtareve te Komisionit te Vleresimit te Ofertave. Vlen te theksohet se, kërkesat e dokumenteve te tenderit duhet te percaktohen te qarta, te sakta dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, volumin dhe objektin e kontrates objekt-prokurimi, me qellim qe te kryhet nje vleresim i drejte dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesemarrjen e ofertuesve

te mundshëm ne nje procedure prokurimi, si dhe duke mos i demtuar pjesëmarrësit ne këtë procedure.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.4. Në nenin 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;
 - b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;
 - c) **konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;**
 - ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;
 - d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.
2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna.
3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.

4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të ankimimit sipas parashikimeve të nenit 110 të këtij ligji.”

III.1.5. Në nenin 38 “Njoftimi i Anulimit” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e vendimit.

2. Njoftimi i anulimit duhet të përmbajë të paktën:

- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;

- numrin e referencës së procedurës;

- objektin e procedurës së prokurimit (përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve);

- emrin, NIPT-et dhe adresat e ofertuesve;

- **arsyet dhe bazën ligjore të anulimit të procedurës, sipas përcaktimeve të nenit 98, të LPP-së.**

3. Autoriteti/enti kontraktor vijon me publikimin e vendimit përfundimtar për anulimin e procedurës së prokurimit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin, duke e publikuar njoftimin në të njëjtën mënyrë siç publikon njoftimin e kontratës.”

III.1.6 Lidhur me pretendimet e ankimuesit, i cili në mënyrë të përmbledhur shprehet se: “Ne këtë akt mungon pjesa arsyetuese mbi të cilën është nxjerrë akti, shpjegimet e rezultatit të vendimit administrativ dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij zbatohen në rastin konkret, çka provon se ky akt/vendim është i paarsyetuar (një ndër parimet bazë të aktit Administrativ) dhe duhet të deklarohet i pavlefshëm pasi cenon interesat e ligjshme të operatorëve ekonomik pjesëmarrës dhe vjen në kundërshtim me dispozitat e ligjit si të LPP-së dhe të K.Pr.Adm.

Pra ligji ka vendosur se duhet të plotësohet të dy kushtet kumulative që të anulohet procedura e prokurimit. A) vlerësimi i KVO-së b) Argumentimi se kush kriter bie ndesh me ligjin material ose ligjin e fushës përkatëse. Ne cdo akt administrativ elementet thelbësore, që nënkuptojnë si përmbajtjen edhe formën e tij, janë autoritetësia e aktit, përshkrimi i lëndës dhe i subjekteve që u drejtohet, arsyetimi dhe dispozitivi. Përmbajtja e aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe i përcaktuar mirë. Këto elemente të formës dhe përmbajtjes së një akti administrativ janë tepër të rëndësishme dhe nuk mund të injorohen. Ato konsiderohen pjesë përbërëse e vet aktit dhe mosrespektimi ose moszbatimi i tyre mund të ndikoj drejtpërdrejt në rregullsinë dhe në vlefshmërinë e tij. Arsyetimi i aktit/vendimit duhet të përfshijë faktet thelbësore, boshtin logjik dhe bazat ligjore që ka pasur parasysh autoriteti kontraktor. Nëpërmjet arsyetimit të aktit qartësohet qëllimi që ka patur organi administrativ në vendimmarrje. Arsyetimi përbën një element thelbësor të formës dhe përmbajtjes së aktit/veprimit administrativ dhe ndikon drejtpërdrejt në vlefshmërinë e tij. Sipas nenit 108, të Kodit të Procedurave Administrative, mosrespektimi i formës dhe elementëve së caktuar nga

ligji është shkak për pavlefshmërinë absolute të aktit.. Kështu, duhet të arsyetohen të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë ose prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejtat dhe interesat e ligjshëm të subjekteve të cilëve u drejtohen. NË rastin konkret mungojnë elementë të formës dhe përmbajtjes së aktit administrativ e për rrjedhojë akti administrativ është i pavlefshëm. SË dyti, çmujmë se të gjitha kriteret kualifikuese janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, kjo procedurë prokurimi është një procedurë e rishpallur nga ana e autoritetit kontraktor dhe në procedurën e mëparshme (REF-40205-08-30-2022.) Me po të njëjtat kriteret kualifikuese po ky autoritet kontraktor vendosi anulimin e procedurës së prokurimit me motivacionin se nuk kishte asnjë ofertë të vlefshme, Kjo procedurë e mëparshme prokurimi, ju nënshtrua dhe hetimit administrativ nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik i cili me vendimin Nr. 322/2023 Sa më sipër, nëpërmjet veprimi të tij, autoriteti kontraktor po cenon dhe parimin e sigurisë juridike. Parimi i sigurisë juridike presupozon, vec te tjerash besueshmërinë e qytetarit tek shteti dhe pandryshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të tjera të mëparshme (shih dhe vendimet e gjykatës Kushtetuese nr.37/2012, nr. 31 dt. 18.06.2010, nr. 24 datë 12.11.2009, nr. 9 datë 26.02.2007). Për sa më sipër shpjeguar, kërkojmë: Anulimin e vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit..[...]",", autoriteti kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues është shprehur me vendim në përgjigje lidhur me këtë pretendim të ankimuesit.

Nga ana e Komisionit konstatohet, se autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi është shprehur, se “ Komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO), nëpërmjet procesverbalit Nr. 1 Date 20.09.2023 "Për hapjen e ofertave të dorëzuara" ka hapur ofertat për procedurën e prokurimit "Sherbim lavanderie për Spitalin Rajonal, Fier". Në date 02.10.2023, KVO nëpërmjet procesverbalit nr. 2 "Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave", ka arsyetuar si vijon: "Gjate procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të kësaj procedure prokurimi, KVO konstaton paqartësi në lidhje me pikat 6 dhe 7 të seksionit 2.3 "Kapaciteti Teknik" të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit. Pika 6, seksioni 2.3 "Kapaciteti Teknik" të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit percakton se: Operatori ekonomik në lidhje me materialin e bute të percaktuar në specifikimet teknike, që do të paraqesë, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet të leshuara nga një organ i autorizuar. Nr. Materialet e Buta Emertimi i produktit Vendi i origjinës Spitali Rajonal, Fier Certificate konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent 1 2 3 Et. Paqartësia verëhet gjate verifikimit të tabelave të paraqitura nga ofertuesit pjesëmarrës në këtë procedure në lidhje me këtë kriter, ku konstatohet se deklaratat për materialet e buta përmbajnë numer të ndryshëm artikujsh dhe konkretisht: Deklarata e paraqitur nga OE "Devis" ShPK përmban 24 artikuj, Deklarata e paraqitur nga OE "Mine Lloshi" PF përmban 25 artikuj, Deklarata e paraqitur nga OE "Univers Servis" ShPK përmban 20 artikuj dhe Deklarata e paraqitur nga OE "Wash & Go Laundry" ShPK përmban 22 artikuj. Pra, mospercaktimi në Tabele të zerave të produkteve nga ana e AK, ka sjelle konfuzion mes ofertuesve në paraqitjen e tyre. Kjo situatë, sjell edhe pamundësinë e KVO për të siguruar një vlerësim të barabartë.

Ndërsa, Pika 7, seksioni 2.3 "Kapaciteti Teknik" të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit percakton se: Operatori ekonomik në lidhje me materialet e pastrimit që do të perdoren për shërbimin e lavanderisë e percaktuar në specifikimet teknike, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet të leshuara nga një organ i autorizuar.

Nr. Materialet e pastrimit Spitali Rajonal Fier

Emërtimi i produktit qe do te lahet; *Vendi i Origjinës së Produktit; Certificate konformiteti ose cilësia CE/ekuivalent*

Nga sa me siper, verehet se kerkesa nuk perputhet me ate cka percaktohet ne tebele. Ne kerkese kerkohen te paraqiten "materialet e pastrimit qe do te perdoren", ndersa ne tebele "emertimi i produktit qe do te lahet". Edhe kjo mosperputhje, ka shkaktuar konfuzion per ofertuesit, ku verehet se, 2 nga ofertuesit pjesemarres kane paraqitur vetem materialet e pastrimit qe do te perdoren, ndersa 2 te tjere kane paraqitur si emertimin e produktit qe do te lahet ashtu edhe materialet e pastrimit qe do te perdoren per produktet perkatese. Mospercaktimet e produkteve dhe mosperputhjet e konstatuara ne kerkesat ne DST, me qellim permbushjen e kriterëve te percaktuara ne pikat 6 dhe 7 te seksionit 2.3 "Kapaciteti Teknik" te Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit, sjellin konfuzion edhe per KVO. Prandaj, duke qene se, KVO nuk mund te siguroje nje trajtim te barabarte ne vleresim per te gjithë OE pjesemares, vendos qe ti propozoje Titullarit te AK, anulimin e kesaj procedure." Ne piken 7, te seksionit 2.3, te kriterëve te vecanta te kualifikimit, ne dokumentet e tenderit eshte percaktuar:

5. Operatori ekonomik ne lidhje me materialet e pastrimit qe do te perdoren per sherbimin e lavanderise e percaktuar ne specifikimet teknike, duhet te plotesoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjines si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i autorizuar.

Nr. Materialet e pastrimit Spitali Rajonal Fier

Emertimi i produktit qe do të lahet Vendi i origjines Certificate konformiteti ose cilësia CE/ekuivalent

Në çdo rast, perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraparak dhe nisjes se afateve te ankimit ofertuesi fitues duhet te paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti. Te dhenat qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates. Nga sa me siper konstatohet se ne kerkesën e ketij kriteri eshte kerkuar qe operatori ekonomik duhet te plotesoje te dhenat e kerkuara ne tebele për materialet e pastrimit qe do te perdoren për sherbimin e lavanderise, nderkohe që ne tabelën e ketij kriteri keto te dhena kerkohen produktet te cilat do te lahen. Kërkesa e ndryshme e produkteve Brenda te njëjtit kriter, ka sjelle si pasoje krijimin e konfuzionit si ne hartimin e dokumentacionit nga ana e ofertuesve, ashtu edhe gjate procesit te shqyrtimit e te vleresimit te ofertave, si dhe duke krijuar hapesire per vleresim subjektiv te ofertave nga ana e anëtareve te Komisionit te Vleresimit te Ofertave. Vlen te theksohet se, kerkesat e dokumenteve te tenderit duhet te percaktohen te qarta, te sakta dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, volumin dhe objektin e kontrates objekt-prokurimi, me qellim qe te kryhet nje vleresim i drejte dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesemarrjen e ofertuesve te mundshëm ne nje procedure prokurimi, si dhe duke mos i demtuar pjesemarrjesit ne këtë procedure.

KPP referuar arsyes së anulimit vëren, se autoriteti kontraktor në vendosjen e kriterëve pika 6, ku kërkon të plotësohet tabela në lidhje me Certificate Konformiteti ose cilësia CE të vendosur nga Njësia e Prokurimit për produktet e buta, kjo kërkesë është evazive dhe konfuzive, pasi si për KVO ashtu dhe për Komisionin e Prokurimit Publik, krijohet paqartësi në mënyrën e përmbushjen e saj nga ana e operatorëve ekonomikë, ashtu dhe në vlerësimin e ofertave. Akoma me tej, vërehet se si në kodet CPV; NOMENKLATURA E KOMBINUAR E MALLRAVE-VKM Nr. 883, datë 27.12.2022, apo dokument tjetër zyrtar, nuk specifikohen në emërtesë, se cilat janë materialet e buta. Gjithashtu, në piken 7, Njësia e Prokurimit ka percaktuar plotësimin e një tebele ku në të citohet "Materialet e Pastrimit" dhe në brendi të saj operatorët duhet të plotësojnë "Emërtimi i Produktit që do të lahet", gjë e cila krijon gjithashtu konfuzion në përmbushjen e kriterit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës ashtu dhe në vlerësimin e tyre. Ndaj referuar arsyes dhe justifikimit të këtij

anulimi, pasi është protokolluar përgjigja e autoritetit kontraktor lidhur me këtë fakt me objekt anulimin e procedurës sipër cituar, konstatohet se një prej kushteve kur autoriteti kontraktor lejohet të anulojë një procedurë prokurimi është pika “c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;” nenit 98 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. KPP gjykon, se anulimi i një procedure prokurimi është në përgjegjësi të autoritetit kontraktor, por me kushtin që të respektojë përcaktimet e nenit 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në rastin konkret autoriteti kontraktor referuar objektit të anulimit, shprehet se gjendet në kushtet, ku ka konstatuar, se ka gabime në formulimin e kriterëve, gjë e cila ka krijuar konfuzion në përmbushjen nga ana e operatorëve ekonomikë për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ndaj referuar objektit të anulimit, kjo e fundit ka justifikuar dhe argumentuar shkaqet të cilat kanë dërguar në anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Devis” SHPK nuk qëndron.

III.2 Lidhur me evidentimin e kryer nga autoriteti kontraktor në procedurën e vlerësimit të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë, ku ka konstatuar, se Njësia e Prokurimit ka kryer shkelje në formulimin e kriterëve, referuar çështjes të mësipërme, KPP gjykon, se ky rast duhet t’i referohet Agjencisë së Prokurimit Publik për nisjen e hetimit administrativ kundrejt autoritetit kontraktor, bazuar në nenin 23 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Devis” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-77870-08-18-2023, me objekt “Shërbim Lavanderie për Spitalin Rajonal, Fier”, me fond limit 51,224,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20-09-2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të këtë në vëmendje këto konstatime në lidhje me procedurat që do të rihedhë.
3. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik, nisjen e hetimeve në bazë të konstatimeve të bëra në këtë vendim.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë derdhjen në buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga “Devis” SHPK .
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**

**Anëtar
Anila Malaj**

**Anëtar
Kreshnik Ternova**

**Kryetar
Jonaid Myzyri**

